



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 88/2 prot.,

Datë 16.01.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM  
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR  
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “BESIM KAMBERI” PF në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr.REF-89010-11-24-2023, me objekt: “*Blerje detergjent për rezervat materiale të Shtetit*” me fond limit 4,040,943 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.
- Ankimues:** “BESIM KAMBERI” PF, me NUIS L42103023G, me adresë: Rruga e Qelqit , Zona Kadastrale Nr 3866 Nr Pasurie 310/20 - Kashar 1001, Tirane
- Autoriteti Kontraktor:** Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara me adresë: Blv ”Dëshmorët e Kombit”, Nd.1, 1001, Tiranë

Në datën 15.01.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 88/2024 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3752 e operatorit ekonomik “BESIM KAMBERI” PF për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr.REF-89010-11-24-2023, me objekt: “*Blerje detergjent për rezervat materiale të Shtetit*” me fond limit 4,040,943 lekë pa TVSH,

zhvilluar me datë 11.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “BESIM KAMBERI” PF.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “BESIM KAMBERI” PF, kundërshton me anë të ankesës me nr. 88 prot.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

#### **Arsyet e skualifikimit:**

*Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 1, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” i Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 19% e vlerës së fondit limit.”*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 16.01.2024.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**